

Sinjalizime

Ekskluzive | Shkon vetë në Polici për t'i raportuar armët me leje të skaduara – 39-vjeçarit nga Klina i sekuestrohen tri pushkë



Sinjali.com

18 Gusht 2026 09:10



Një rast jo fort i zakonshëm është regjistruar të hënën në Klinë, ku një 39-vjeçar është paraqitur vetë në Stacionin Policor për të raportuar tri armë që figuronin në emrin e tij, por lejet për to kishin skaduar, mëson Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se bëhet fjalë për Visar Morinën rreth 39-vjeç nga fshati Jashanicë i Klinës, i cili jeton dhe punon në Gjermani.

Morina është paraqitur në Polici më 17 gusht, rreth orës 13:50, duke njoftuar se posedonte dy pushkë gjuetie dhe një pushkë ajrore, të regjistruara në emrin e tij, por për të cilat lejet përkatëse nuk ishin më të vlefshme.

Pasi është njoftuar Prokurori kujdestar, është urdhëruar sekuestrimi i armëve dhe intervistimi i Morinës në cilësinë e të dyshuarit për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Me pëlqimin e tij, zyrtarët policorë kanë shkuar së bashku me Morinën në shtëpinë e tij, ku kanë sekuestruar dy pushkë gjuetie, njëra prej tyre e prodhimit turk, si dhe një pushkë ajrore.

Gjatë intervistimit, 39-vjeçari ka deklaruar se jeton dhe punon në Gjermani dhe se, për shkak të qëndrimit jashtë Kosovës, nuk kishte arritur të kujdesej për vazhdimin e vlefshmërisë së lejeve.

Ai ka deklaruar gjithashtu se prindi i tij është në moshë të shtyrë dhe me probleme shëndetësore, ndaj, për të shmangur çdo përgjegjësi të mundshme në të ardhmen lidhur me armët që figuronin në emrin e tij, kishte vendosur t'i raportonte dhe t'i dorëzonte ato vullnetarisht.

Pas intervistimit dhe konsultimit me Prokurorin e Shtetit, Morina është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa rasti do të procedohet më tej përmes kallëzimit penal.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

ARMA

dorëzim

Klina

Policia

sekuestrim

Të tjera:



Ekskluzive | Alarm për armë në “Eclipse” në Ferizaj, Policia zbarkon në lokal – arrestohet...

Sinjalizime



Ekskluzive | Hajni tenton t'ia mbathë nga kati i tretë, policët i shkojnë pas nëpër ballkone – 3...

Sinjalizime




Gjendet 15-vjeçarja nga Peja që ishte raportuar e zhdukur – Policia e lokalizon pas kërkimev...

Sinjalizime



Policia shpëton një 21-vjeçare në Podujevë – tentoi të hidhej nga kati i tretë i një objekti në...

Sinjalizime



Ekskluzive | Ky është i dyshuari që lu gjetën AK-47 e pistoletë në bagazhin e BMW-së n...

Sinjalizime



Policia e Kosovës ndan mbi 45 mijë euro për renovimin e qendrave të ndalimit në Gjakovë

Siguri



Pejë: Policia shqipton masa ndaj 171 motoçiklistëve për kundërvajtje në...

Siguri



Ekskluzive | Këta janë dy të dyshuarit për sulmin ndaj policëve në Vushtrri – gjithçka nisi...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtimi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Internet
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera